

Hapet thirrja për aplikime për bursa trajnimi në Universitetin Middle East Technical University (METU), në Ankara, Turqi, për stafin akademik për mësimdhënie, stafin akademik për trajnim, stafin ndihmës akademik me karakter administrativ për trajnim dhe stafin administrativ për trajnim të Universitetit të Tiranës.

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik për mësimdhënie, stafin akademik për trajnim, stafin ndihmës akademik me karakter administrativ për trajnim dhe stafin administrativ për trajnim të Universitetit të Tiranës.

Llojet e mobilitetit:

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;
- Shkëmbimin e stafit akademik për trajnim;
- Shkëmbimin e stafit ndihmës akademik me karakter administrativ për trajnim;
- Shkëmbimin e stafit administrativ për trajnim;

Kohëzgjatja:

- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit;

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin ditor për stafin (140 EUR në ditë);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| DISTANCA E UDHËTIMIT (http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm) | Kompensimi |
|---|------------|
| Midis 100 dhe 499 KM | 180 EUR |
| Midis 500 dhe 1999 KM | 275 EUR |
| Midis 2000 dhe 2999 KM | 360 EUR |
| Midis 3000 dhe 3999 KM | 530 EUR |
| Midis 4000 dhe 7999 KM | 820 EUR |
| 8000 KM ose më shumë | 1100 EUR |

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze);

- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Certifikata e gjuhës së huaj (që vërteton njohuritë e gjuhës angleze niveli B2);
- Letër konfirmimi nga Universiteti dërgues;
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie*;
- Plani i mobilitetit për trajnim*;

Për të shkarkuar Letrën e Konfirmimit nga Universiteti dërgues klikoni në linkun:

http://www.unitir.edu.al/images/Home_Univ_Confirmation.docx

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Teaching_Mobility_Plan.pdf

*Plani i Mobilitetit për mësimdhënie është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së mësimdhënies. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Trajnim klikoni në adresën:
http://www.unitir.edu.al/images/Bursat/Training_Mobility_Plan.pdf

*Plani i Mobilitetit për trajnim është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së trajnimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +, Z. Elton Skendaj.

Për më shumë informacion mbi Universitetin Middle East Technical University referohuni link-ut të mëposhtëm:

<https://www.metu.edu.tr/faculties-institutes-schools>

Afati për aplikim: 19 Prill 2018

Dokumentacioni duhet dorëzuar dorazi në Rejtoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Komunikimit, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe të skanuara në formatin PDF dhe të dërgohen në adresën iro@unitir.edu.al.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë në adresën: iro@unitir.edu.al

Universiteti i Tiranës ju uron Suksese në aplikim!